



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:051594
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847807

KPPP.nr.664/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “DT MINING SH.P.K., me NUI:811287350, me seli në Prishtinë Rr.”Hajrullah Abdullahu” nr.30, Bregu i Diellit, kundër debitorit “DP & PARTNERS” Sh.P.K., me NUI:811302471, me pronar D.P., me seli në Prishtinë Rr.”Enver Maloku”, Kompleksi Tregtia pn., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.291/21 të datës 26.02.2021 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi me seli në Magjistralen Prishtinë- Shkup, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “DP & PARTNERS” Sh.P.K., me NUI:811302471, me seli në Prishtinë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, për faturën me numër 20-SHV01-001-115 e datës 02.10.2020, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,000.00 €.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “DP & PARTNERS” Sh.P.K., me NUI:811302471, me seli në Prishtinë, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 207,996.41 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit I“DT MINING SH.P.K, me NUI:811287350, ndaj debitorit “DP & PARTNERS” Sh.P.K., me

NUI:811302471, me seli në Prishtinë, sipas urdhrit P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, i Përmbauesit Privat Isa Gacaferi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,000.00 €.

- IV. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 207,996.41 euro.
- V. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbauesit Privat P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, me të cilin ka lejuar përmbauesin, në bazë të dokumenteve të besueshme – fatura me numër 25/19 e datës 30.11.2019, fatura me numër 5/20 e datës 22.01.2020, fatura me numër 8/20 e datës 13.02.2020, fatura me numër 14/20 e datës 07.04.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-25 e datës 30.05.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-56 e datës 21.07.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-59 e datës 30.07.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-43 e datës 01.07.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-62 e datës 30.07.2020 dhe fatura me numër 20-SHV01-001-115 e datës 02.10.2020, në bazë të këtyre faturave debitori është i obliguar ti paguaj kreditorit shumën prej 365.216,80 euro, meqenëse debitori nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin, e ka urdhëruar debitorin në emër të borxhit të mbetur t'ia paguaj kreditorit shumën totale në vlerë prej 212,996.41 €, me kamatë ligjore prej 8 %, shpenzimet e procedurës përmbauese që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, nën kërcënim të përmbauesit me dhunë. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbauesi privat të zbatoj përmbauesin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori ka parashtruar prapësimin përmes të cilit e kundërshton urdhrin përmbauesit Privat, ndër të tjerash ka theksuar se urdhri për përmbauesin është lëshuar në bazë të faturave fiktive të kreditorit, sepse debitori i ka përmbushur detyrimet e tij ndaj kreditorit dhe se faturat në bazë të cilave është caktuar përmbauesi nuk paraqesin dokument të besueshëm. Ka shtuar se urdhrin përmbauesit Privat e kundërshton duke u bazuar në nenin 71 par.1 nënpar.1 dhe 1.6 të LPP-së, nga se kreditori nuk ka pasur të drejtë që të kërkoj kompensimin monetar sepse kompensimi është kontraktuar me asete të debitorit e për të cilat kreditori është pajtuar, prandaj nga këto arsye

rezulton se dokumenti përmbartimor nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe se faturat në bazë të cilave është caktuar përmbartimi nuk paraqesin dokument të besueshëm. Andaj i ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, të anulohet urdhri përmbartimor si dhe të obligohet kreditori që t'i mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, ka deklaruar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë dhe si të tilla janë të pa bazuara. Ndër të tjerash ka theksuar këtu nuk kemi të bëjmë me asnjë faturë fiktive por kemi të bëjmë me fatura reale dhe të pranuar nga debitori që në të njëjtën kohë janë të deklaruara në ATK. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi se i ka përmbushur obligimet ndaj kreditorit për shkak se përmes llogarisë bankare dëshmohet qartë se debitori nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit. Po ashtu e ka kundërshtuar pretendimin se debitori me kreditorin janë kompensuar përmes kontratave. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pa bazuar dhe urdhri për përmbartim të vërtetohet.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se urdhri përbarimor me numër P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas faturës me numër 20-SHV01-001-115 e datës 02.10.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, pasi që nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – fatura me numër 20-SHV01-001-115 e datës 02.10.2020, nuk i plotëson kushtet ligjore, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se është dorëzuar tek debitori, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar dhe as e vulosur nga ana e debitorit dhe nuk ka provë se e njëjta është dorëzuar në ndonjë formë tek debitori, dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përbarim për këtë arsye vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi Urdhrin e Përbaruesit Privat P.nr.291/21 të datës 26.02.2021, për pjesën tjetër të detyrimit, për faktin se dokumenti i besueshëm – fatura me numër 25/19 e datës 30.11.2019, fatura me numër 5/20 e datës 22.01.2020, fatura me numër 8/20 e datës 13.02.2020, fatura me numër 14/20 e datës 07.04.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-25 e datës 30.05.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-56 e datës 21.07.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-59 e datës 30.07.2020, fatura me numër 20-SHV01-001-43 e datës 01.07.2020 dhe fatura me numër 20-SHV01-001-62 e datës 30.07.2020, në bazë të cilave është iniciuar propozimi për përbarim, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së. Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit, gjithashtu të njëjtat janë paguar pjesërisht.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, me të cilin përcaktohet se: “*Në rast se e*

aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore në këtë procedurë, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera kreditorit dhe debitorit të paraqitur, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.664/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.